



Më
Data

13 - 08 - 2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:027424
Datë: 09.08.2018
Numri i dokumentit: 00098923

P.nr.2930/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues, Elmaz Zenuni, me Zyrtarin ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Shkupi Rruga [REDACTED] Nr. [REDACTED] Shkup-Republika e Maqedonisë, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.2006-5/16 të dt.10.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 09.08.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit, në të njejtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, [REDACTED] nga Shkupi Rruga [REDACTED] Nr. [REDACTED]-Republika e Maqedonisë, i lindur më [REDACTED] në Shkup, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], shitës privat, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë, mbrohet në liri,-

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 18.10.2016, rreth ores 14:50 në Rrugën "Driton Islami", në Ferizaj, saktësisht në hyrje të terminalit doganor në Ferizaj, i ka penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, derisa njësia policore regjionale e hetimeve të autokrimeve ishin në përcjellje të kamionit "Man" me targa të regjistrimit [REDACTED] me qëllim hetimi dhe verifikimi dhe derisa kanë qenë duke hyrë brenda barierës së terminalit, i pandehuri ka penguar duke folur dhe ka reaguar me duar, duke mos lejuar që kamioni të vazhdojë për në terminal, i njëjti ka refuzuar që të largohet derisa është arrestuar,-

Me këte ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 409 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 4,7, 8 par.1, 9,10 par.1,17 par.1, 21 par.1 dhe 2, 41, 42 par.1 nënpar.1.1, 43 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 45, 46, 47, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366, 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e :

GJYKON

Denohet me DENIM ME GJOBË në shumën prej 200 euro (me shkronja:Dyqind euro), të cilin denimin i pandehuri do ta paguaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i denuari nuk e paguan gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, i akuzuari nuk ëshiron apo nuk mundet të paguaj gjobën e shqiptuar do ta vuaj denimin,ashtu që për çdo 20 euro do të vuaj nga 1(një) ditë burgu.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor të paguan shumën prej 20 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të

Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Ar sy etimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II nr.2006-5/16 të dt.10.11.2017, e ka ngarkuar të pandehurin, [REDAKTUAR] nga Shkupi Rruga [REDAKTUAR] Nr [REDAKTUAR] Shkup- Republika e Maqedonisë, për shkak të vepres penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së, me datën 09.08.2018, mbajti shqyrtimin fillestar ku prezentuan prokurori i shtetit Valdet Avdiu, i pandehuri.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimit të fajsisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit përkitazi me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqyrtimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ato: deklarata e të pandehurit dhënë në procedurën hetimore, si dhe e dëshmitarëve : [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] -zyrtar policor në Ferizaj,
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, ndashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e Gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe

- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

I akuzuari [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar në fjalën e tij në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon prokuroria është penduar thellë për atë që e ka kryer por nuk ka mundur ti kontrolloj veprimet e veta, kërkon falje për këtë veprë, i premtton gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej asnjë veprë penale dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit si rrethana letësuese ti ketë theksësimet e sipër theksuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë egzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figureën e veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.1 të KPRK-së.

(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të ketë qenë e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën për veprën e kryer, ka kërkuar falje për veprimet e ndërmmarrura, është i moshës së re, i pa martuar, duke qenë e bindur se me rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave duke i caktuar dënim të butë dhe atë me gjobë.

Numri i lëndës: 2018:027424
Datë: 09.08.2018
Numri i dokumentit: 00098923

Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPPRK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 €, i cili është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të të akuzuarit, dhe çështje penale të zhvilluar.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P.nr.2930/2017 të dt.09.08.2018

Zyrtari ligjor,
Gazmend Bytyqi

Gjyqtari,

Elmaz Zenuni



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.